SKEMA E ÇERTIFIKIMIT
PER
AUDITOR DHE KRYEAUDITOR TE
ISO 45001

Hartoi : Menaxheri Teknik
Claudio Cesaroni

Miratoi : Administrator
Gian Paolo Venezia

1. QELLIMI DHE FUSHA E APLIKIMIT

Ky dokument synon të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet AUTENTICERT, i cili funksionon si një organizëm certifikues të personit dhe individëve që kërkojnë certifikim vullnetar nga palët e treta për aftësitë e tyre si *Auditorë / kryeauditorë te standarteve nderkombetare* .

Certifikimi i personit është i aplikueshëm ndaj personit fizik që bën kërkesë, ose ndaj personit fizik që kompania e tyre ben kërkesë për ta e cila nuk është e zbatueshme te kompanit/organizatat.

2. TE PERGJITHSHME

Për kryerjen e veprimtarisë së certifikimt, AUTENTICERT kryen, vlerësimin direkt të kandidatit ose për dobi të Organizmave të tjera të jashtëm të përzgjedhur, të kualifikuar dhe miratuar nga ata.

Trupa certifikuese duhet të kenë vendodhje, pajisje (nese është e aplikueshme), instrumente dhe persona teknik për të kryer aktivitetin. AUTENTICERT .

AUTENTICERT mund të certifikoj një numër të pakufizuar personash në organizatë.

3. PËRSHKRIMI I AUDITORËVE

Figura profesionale e Lead Auditor/ Auditorit të Sistemeve të menaxhimit mjedisor (OHSMS) është një person që planifikon, kryen dhe raporton auditime të një sistemi të menaxhimit të shendetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me kërkesat e standardit UNI EN ISO 45001:2018 dhe udhëzimeve ISO 19011:2018. Lead Auditori /Audituesi duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe i lirë nga konfliktet e interesit, i aftë të mbledhë prova objektive dhe t'i vlerësojë ato objektivisht për të përcaktuar pajtueshmërinë me kriteret e auditimit (politikat, procedurat dhe kërkesat rregullatore). Ai është gjithashtu përgjegjës për vlerësimin e efektivitetit të proceseve dhe kontributin e sistemit të menaxhimit në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së organizatës.

Audituesi/kryeauditori duhet të kanë njohuri si në vijim:

- Terminologjin, parimet, të jetë njohes i mirë i sistemeve të menaxhimit;
- Standardet dhe dokumentet rregullatore ,etj;
- Sektorët/fushat e biznesit të klientit;
- Produktet, proceset në mënyren e organizimit të klientët;
- Sistemet e vlerësimit të konformitetit;
- Llojet proceset e auditimit;
- Rolin, përgjegjësit dhe parimet të etikës profesionale lidhur me figurën e Audituesit dhe kryeauditesit
- Menaxhimi efektiv të auditit.
- Metodologjisë dhe teknikave e zhvillimit të të gjitha fazave të aktivitetit të Auditimit dhe menaxhimi i takimeve dhe të grupit të auditimit;
- Menaxhimi i rrezikut menyra si aplikohet në procesin e auditimit;
- Kërkesat ligjore në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë të cilat do të respektohen

përgjatë vlerësimit.
- Përgjegjësiat civile dhe masat ndëshkuese që rrjedhin si pasojë e raportit të auditimit/vlerësimit

Aftësitë

Audituesit/ kryeaudituesit duhet të jetë në gjendje:
- Të aplikoje, në auditime të ndryshme, parimet kryesore, procedurat dhe menyrat e auditimit për të garantuar që auditimi të jenë i drejtuar në mënyre korrekte dhe në zbatim të rregullave.
- Të kuptoj terrenin dhe të aplikoj kriteret e auditimit.
- Të kuptoj strukturën dhe mënyrën e organizimit të organizatës e cila është objekt i auditimit.
- Të punoj në menyrën ligjore sipas rregullave që ka vendosur organizata.
- Të përdorë një gjuhë të kuptueshme nga të gjitha shtresat intelektuale të cilet punojnë në organizatën e klientit.
- Të mbaj shënime dhe të ndërtoj raporte me shkrim.
- Të bëj prezantime dhe intervista;
- Të përcaktoj ligjet, rregulloret, direktivat, etj, që kanë lidhje me organizimin e kompanisë që do të përfshihet në auditim.

Përkufizime

Njohuri: Rezultat i asimilimit të informacionit përmes të nxënit

Aftësitë: Aftësia për të aplikuar njohuri për të përfunduar detyrat dhe zgjidhjen e problemeve

Kompetencë. Aftësia për të vënë në zbatim njohuritë dhe aftësitë, për të arritur rezultatet e duhura.-

Sjellja Personale

Auditorët duhet të zotërojnë aftësi të nevojshme për të arritur të menaxhojnë dhe të veprojnë në menyrë korrekte sipas rregullave dhe parimeve të auditimit.

***Auditori duhet të**:*

- të respektojë parimet e etikës (i drejtë, i paanshëm, i sinqertë, i ndershëm dhe i rezervuar)
- të jetë mendjehapur (për të marë në konsideratë, ide dhe pikëpamje të ndryshme)
- jete dipllomat (të ketë takt në mardhëniet me njerëzit)
- jete i vëmendshëm për të vënë re detajet (vëzhgues aktiv i aktiviteteve dhe i mjedisit përreth);
- jete vigjelent (i vetëdijshëm për situatat dhe të jetë i aftë për t'i kuptuar ato);
- jete i gjithanshëm/ kameleon (i aftë për t'u përshtatur lehtësisht në cdo lloj situatash të ndryshme);
- jete këmbëngulës (bindës dhe i fokusuar në arritjen e qëllimeve);
- jete i vendosur (i aftë për të arritur menjëherë në përfundime të bazuar në analiza dhe

arsyetime logjike);
- jete me vetëbesim (të aftë të veprojë dhe të sillet në mënyrë të pavarur dhe në të njëjtën kohë të ndërveprojë në mënyrë efektive);
- jete i aftë për të vepruar me vendosmëri (d.m.th. në mënyrë të përgjegjshme duke rruajtur etikën);
- jete i hapur për përmirësim (i etur për përmirësim nga situatat e krijuara dhe i përkushtuar për të marrë rezultatet më të mira nga auditimi);
- jete i ndjeshëm ndaj diversitetit kulturor (i vëmendshëm dhe i respektueshëm ndaj kulturave të ndryshme brenda organizatës së audituar);
- jete bashkëpunues (i aftë për të bashkëvepruar në mënyrë efektive me të tjerët, duke përfshirë anëtarët e grupit auditues dhe stafin e organizatës së audituar).

3.1 ANGAZHIMET E AUTENTICERT

AUTENTICERT garanton akses në shërbimet e veta për kandidatët aplikantët, pa ndonjë diskriminim të karakterit financiar ose kushte të tjera të panevojshme. AUTENTICERT njeh rëndësinë e paanshmërisë në certifikim: për këtë arsye ajo kryen aktivitetet e saj në mënyrë objektive, duke shmangur çdo konflikt interesi. Në veçanti, AUTENTICERT merr përsipër të mos përdorë si ekzaminues për vlerësimin e kandidatëve, qe mund të ketë ndonjë konflikt të mundshëm interesi. Ky kusht shtrihet edhe tek ekzaminuesit e çdo organizate të kualifikuar për vlerësim. Të gjitha funksionet e përfshira në procesin e certifikimit te personelit janë në përputhje me Kodin e Etikës.
Certifikimi është i bazuar në vlerësimin pozitiv të secilit kandidat bazuar në rezultatet e tij të testeve me shkrim dhe gojë.

3.2 ANGAZHIMET E KANDIDATIT

Kantidati duke i dërguar kërkesën për certifikim AUTENTICERT, i përmbahet skemës e certifikimit dhe e pranon, duke e nënshkruar formularin e aplikimit, duke rënë dakort për të gjitha fazat e procesit i vlerësimit, certifikimin dhe regjistrimet e përshkruar në vijim.
Për të marrë dhe mbajtur certifikimin, aplikanti duhet të pranoj që do të zbatoj të gjitha kërkesat referuar standarteve që kërkon certifikimi, kërkesat shtesë të përcaktuara nga AUTENTICERT dhe nga ogane të tjera të vlerësimit të konformitetit, si dhe të gjitha kërkesat të cilat janë parashtruar në këtë dokument. Kandidatët janë të detyruar të respektojne kodin e etikes.

4. REFERENCAT

Të gjitha referencat ndaj ligjeve, standardeve dhe dokumenteve të AUTENTICERT *të cilat nuk janë të datuar kuptohet që zbatohet rishikimi i fundit i tyre.*

- Referencat mbi rregullatoret për vlerësimin e Auditimit:
  - ISO 19011
  - ISO 45001: 2018 SISTEMET E MENAXHIMIT TË SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË (OHSMS)
  - ISO / IEC TS 17021-10

Referencat AUTENTICERT për certifikimin e personit:

- ISO / IEC 17024 "Kërkesat të përgjithshme për organizmat që kryejnë certifikimin epersonave"
- Skemat e certifikimit.
  Etj.

5. PËRKUFIZIMET

Procesi i çertifikimit Aktivitetet, me të cilat një trupë çertifikuese, përcakton që një person përmbush **kërkesat e çertifikimit,** duke përfshirë aplikimin, vlerësimin, vendimin për çertifikimin/riçertifikimin, përdorimin e **çertifikatave** dhe logon/simbolet.

Skema e çertifikimit kërkesa të tjera lidhur me specifikimin profesional, ose kategoritë aftësisë të personave**.**

Njohuri: Rezultat i asimilimit të informacionit përmes të nxënit

Aftësitë: Aftësia për të aplikuar njohuri për të përfunduar detyrat dhe zgjidhjen e problemeve

Kompetencë Aftësi e provuar për të përdorur njohuritë, aftësitë dhe aftësitë personale në situata pune ose studimi dhe në zhvillim profesional e personal, që mund të ushtrohet me një shkallë të caktuar autonomie p.sh. përgjegjës.

Kërkesat e çertifikimit. Teresia e kërkesave specifike, duke përfshirë kërkesat e për metodologjinë, që duhet të përmbushen, për të vendosur ose për të mbajtur çertifikimin.

Pronari i skemës. Organizata përgjegjëse, për zhvillimin dhe mbajtjen e **skemës së çertifikimit.** *(Organizatë, mund të jetë vetë organizmi çertifikues, një autoritet qeveritar, ose një tjetër.)*

Çertifikatë. Dokument i lëshuar nga një organizëm çertifikues, sipas dispozitave të Standardit Ndërkombëtar, që tregon se personi i caktuar, ka përmbushur **kërkesat e çertifikimit.**

Kualifikimi. Demonstrim i arsimimit, trajnimit dhe përvojën së punës, aty ku është e zbatueshme.

Vlerësim. Proces, që vlerëson përmbushjen nga një person të kërkesave të **skemës së çertifikimit.**

Provim. Mekanizëm që është pjesë **e vlerësimit**, që mat aftësinë **e kandidatit**, **kompetencën** me një kandidati, me anën e një, ose më shumë mënyra; me shkrim, me gojë, në praktikë dhe vëzhguese, siç përcaktohet në **skemën e çertifikimit**

Kontrollues. Personi kompetent për të drejtuar dhe vlerësuar një **provim,** ku provimi kërkon gjykimin profesional.

Mbikqyrës. Personi i autorizuar nga organizmi çertifikues, i cili administron ose mbikëqyr një provimin, por që nuk vlerëson **kompetencën e kandidatit.**

Personel. Individët, të brendshëm ose të jashtëm, të organit çertifikues, që kryejnë aktivitete për organizmin çertifikues. *(këta përfshijnë anëtarët e komiteteve dhe vullnetarët.)*

Aplikant Personi i cili ka paraqitur një kërkesë, për tu pranuar në **procesin e çertifikimit .**

Kandidat. Aplikant, i cili ka përmbushur kushtet paraprake të specifikuara dhe është pranuar në procesin e çertifikimit.

Paanësi. Prania e objektivitetit.

Shënim 1: Objektivitet do të thotë që konfliktet e interesit nuk ekzistojnë, që janë zgjidhur,në mënyrë të tillë që nuk mund të ndikojë negativisht në aktivitetet e mëvonshme të organizmit çertifikues.

Shënim 2: Terma të tjera, që janë të përdoshëm në përçimin e elementit të paanësisë, janë pavarësia, mospasja e konfliktit të interesave, mospasja e tendencës, mungesa e paragjykimit, neutraliteti, të qenit i drejtë, gjerësia, drejtësia, ç'interesimi, barazpesha.

Drejtësia Sigurimi i mundësive të barabarta për çdo kandidat në procesin e çertifikimit.

Vlefshmëri Dëshmi se vlerësimi mat atë që është menduar të matet, siç përcaktohet nga çertifikimi skema

BesueshmëriaTreguesi i shkallës, në të cilën rezultatet e ekzaminimit janë të qëndrueshme përgjatë kohëve dhe vendeve të ndryshme të provimeve, format e ndryshme të ekzaminimit dhe ekzaminuesve të ndryshëm.

Apelim Kërkesa nga aplikanti , kandidati ose personi i çertifikuar, për rishikimin e çdo vendimi të marrë nga organizmi çertifikues, në lidhje me statusin e dëshiruar të çertifikimit të tij / saj

Ankesë Shprehja e pakënaqësisë, e ndryeshme nga apelimi, nga çdo individ ose organizatë, për një organizëm çertifikues, lidhur me aktivitetet e organizmit, ose një personi të çertifikuar, ku pritet një përgjigje. *SHËNIM Adaptuar nga ISO / IEC 17000: 2004, përkufizimi 6.5*

Palë e interesuar Individ, grup, ose organizatë i ndikuar nga performanca e një personi të çertifikuar ose organizmi çertifikues. (*Person i çertifikuar; përdoruesi i shërbimeve të personit të çertifikuar; punëdhënësi i personit të çertifikuar; klient; autoritet shtetëror.)*

Mbikëqyrje Monitorimin periodik, gjatë periudhës së çertifikimit, të performancës së personit të çertifikuar, për të garanturuar konformitetin e tij, në pajtueshmëri me skemën e çertifikimit.

Ekzaminuesi: personi që ka kompetencën për të zhvilluar një provim dhe, kur ky provim kërkon një gjykim profesional të kandidatit, për të vlerësuar rezultatet.

Objekti/ sipërfaqa e strukturës /vendodhja: qendra e provimit, zyrat vleresimit të kompetences, i vlerësuar nga organizmi në të cilën kryhen provimet e certifikimit nën kontroll dhe sipas procedurave specifike të organizmit.

Rishikimi i procesit të certifikimit (RCP) (Review of the certification process): faza e shqyrtimit të brendshëm të procesit të certifikimit për të lejuar lëshimin e certifikatës.

6. PROCEDURA E ÇERTIFIKIMIT

6.1 KËRKESA PËR ÇERTIFIKIM

Mund të hyjnë në provim kandidatët që plotësojnë kërkesat minimale te specifikuara në piken 6.2 ,

6.2 KËRKESAT BAZË

✓ **Auditori**

Të jetë në posedim të një diplome të arsimit të mesëm ose kualifikim ekuivalent ose diplomë preferenciale në disiplinat mjedisore, inxhinierike ose të sigurisë.

✓ **Lead Auditor**

Të jetë në posedim të një diplome të arsimit të larte

Edukimi

-Formimi dhe Trajnimet Specifike

- Është e nevojshme të ketë ndjekur një kurs të kualifikuar për Auditor/Auditor Kryesor të sistemeve të menaxhimit të cilësisë (minimumi 40 orë), në përputhje me ISO 45001 dhe ISO 19011, me kalimin e një provimi përfundimtar.
- Dhe të ketë ndjekur një kurs të kualifikuar për Auditor/Auditor Kryesor të sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (minimumi 24 orë), në përputhje me ISO 45001, me kalimin e një provimi përfundimtar.

Përvoja në punë.

Kërkohet eksperiencë e dokumentuar (libreza e punës / kontrata /etj) ku demostrohet përvoja e punës ne menyre te vijueshme.

Auditor

-Nëse posedoni një diplomë të arsimit të mesëm, 3 vjet përvojë profesionale në figurën e referencës;

-Nëse posedoni një diplomë: 1 vit përvojë profesionale në figurën e referencës

Lead Auditor

- 3 vjet përvojë profesionale në figurën e referencës;

Përvoja nga auditimet

✓ Auditori

Duhet të ketë marrë pjesë në të paktën 3 auditime të plota të kryera në 3 vitet e fundit.

✓ Lead Auditor

-Duhet të ketë marrë pjesë në të paktën 5 Auditime të plotë, të cilat janë kryer në 4 vende të ndryshme

Trajnimet

Nëse aplikantët kanë nevoje për trajnime specifike, AUTENTICERT do ti mbështesë ata, duke marre të gjitha masat e moshkeljes së paanshmerisë dhe konfliktit të interesit.

6.3 KËRKESA TE VECANTA

Aplikanti mund kryej provimin sipas njërës nga kërkesave të mëposhtme.

6.3.1 Aplikanti që ka nje certifikim të vlefshëm si auditor/kryeauditor, lëshuar nga një **Trup certifikimi të personit e akredituar,** dhe ve në dispozicion të gjithë dokumentacionin për të vërtetuar certifikimin, mund të pranohet të kryej vetëm provimin me gojë

6.3.2 Aplikanti që ka nje certifikim të vlefshëm si Auditor/Kryeauditor, lëshuar nga një **nga një Trup e certifikimit të personit e njohur**, dhe ve në dispozicion të gjithë dokumentacionin për të vërtetuar certifikimin, mund të pranohet të kryej vetëm provimin me gojë

6.3.3 Aplikanti që është certifikuar si Kryeauditor dhe/ose Auditor e me certifikatë të lëshuar nga një Organizëm Certifikimi i Personi i akredituar, i cili dokumenton kërkesat si me poshtë:

- Eksperiencë të vazhduashme prej të paktën 2 vitesh në fushën përkatëse.
- ndjekja një kursi kryeauditor prej të paktën 24 orësh.
- të ketë kryer në 2 vitet e fundit, të paktën 3 auditime të plota, jo të gjitha të brendshme, të kryera në kompani të ndryshme, në rolin e Auditorit/Kryeauditorit.

mund të pranohen në të 2 testet me shkrim: kazus i auditimit dhe provim me shkrim e përgjithshme + provimi me gojë.

AUDITET E VLEFSHME PËR QËLLIME TE ÇERTIFIKIMIT:

Për qëllime certifikimi konsiderohen të vlefshme vetëm auditimet :

- të kryera sipas kërkesave për kryevauditor, dhe duke mbuluar të gjitha fazat e përshkruara nga 6.3 deri në 6.6 të ISO 19011, edhe nëse janë kryer në kohë të ndryshme, me kusht që kohëzgjatja e përgjithshme e auditimit në terren të jetë jo më pak se 8 orë (1 ditë pune). Për çdo auditim, të vlefshëm i cili njihet si 1 ditë pune, do të shtohet një ditë shtesë (për cdo ditë auditimi) për shqyrtimin e dokumentacionit dhe përgatitjen e raportit, duke e përfshirë në numrin total të ditëve të kërkuara.

Për qëllime certifikimi nuk janë të vlefshme auditimet e mëposhtme :

- që kanë të bëjnë vetëm me monitorimin e zbatimit të veprimeve korrigjuese dhe auditimeve të kryera sipas standardeve që nuk janë ekuivalente me standardin ISO 45001.
- që kryhet vetëm nga eksperti teknik.

6.4 KONTRATA CERTIFIKIMIT

Aplikanti, me nënshkrimin e formularit të aplikimit, pranon kushtet ekonomike të përgjithshme të kontratës kushtet e organizmit të certifikimit dhe ato që vijnë si rrjedhojë e skemave të certifikimit.

Në rastin kur aplikanti nuk i paguan vetë tarifat e certifikimit dhe të mirëmbajtjes atëherë ai duhet të përcaktoj në formularin e aplikimit personin ose/dhe subjektin dhe si do të kryen detyrimet (paguen faturat). Aplikanti duhet të dorëzoj NIPT-in e kompanisë.

Në kontratën e certifikimit është përcaktuar kohëzgjatja 3 vite ku përfshihen edhe mirëmbajtjet e certifikimit (të paktën 1 herë në vit), të detajuara në paragrafin 10 të kësaj skeme.

7 PROCESI VLERËSIMIT

Vlerësimi i kandidatit nga fillimi i procesit deri në marrjen e certifikatës AUTENTICERT, bëhet nëpërmjet fazave/etapave, të përcaktuara si në kohë ashtu dhe në detyrime, për secilën prej fazave të mëposhtme:

- vlerësimi i kandidatit nëpërmjet dokumentave, për të verifikuar plotësimin e kërkesave të Skemës së certifikimit.
- Provimi i certifikimit, i kryer nga Komisioni i Ekzaminimit AUTENTICERT, siç përcaktohet në pikën 8 të këtij dokumenti;
- Rivlerësimi i dokumentave dhe i rezultateve të provimit
- Miratimi i propozimit për certifikim nga menaxheri teknik i fushës.
- Lëshimi i certifikatës së regjistruar në regjistrin e AUTENTICERT dhe të publikuar në faqen e zyrtare te Autenticert.
- Njoftim.

Nëse përgjatë vlerësimit të fazave një nga rezultatet është negativ, procesi bllokohet dhe njoftohet kandidati. Për të vazhduar me procesin e certifikimit, do të jetë e nevojshme që fillimisht të zgjidhen mangësitë e konstatuara, brenda afateve të përcaktuara nga AUTENTICERT.

8. PROCESI PROVIMIT

8.1 KËRKESAT PËR PRANIM NË PROVIMIN E ÇERTIFIKIMIT

Të gjithë ata që, pasi kanë aplikuar përmes formularit të aplikimit dhe kanë dokumentuar plotësimin e kërkesave minimale dhe jane konsideruar te pershtatshem.

Vlerësimi i kompetencës sipas dokumentacionit dhe plotësimi i dosjes në mënyrë korrekte kryet nga vleresuesi paraprak për këtë proces bashkë me një teknik të kësaj fushe/skeme. (vlerësuesi teknik jo doemos mund të jetë punonjës i AUTENTICERT-it por duhet punoj për ta)

Për aplikantët që nuk flasin gjuhën shqipe, AUTENTICERT do te siguroje një përkthyes i cili do ndihmoj për të kuptuar me saktë, si në provimin me shkrim ashtu dhe me gojë, dhe mund të kërkojë dëshmi të kurseve të njohura.

Në kërkesën e certifikimit përcaktohet Aplikanti / fusha / kodi IAF që i intereson për të cilin ai përmbush kërkesat. Verifikimi i kompetences teknike bëhet gjatë provimit të certifikimit.

AUTENTICERT vë në dispozicion formularët e mëposhtëm, që përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të verifikuar plotësimin e kërkesave për tu certifikuar:

- Formulari i regjistrimeve të auditeve per SMC per tu validuar nga komiteti.
- Faksimile/letra reference ose cfarë do lloj tjeter dukumenti që demostron kompetencen në fushën e kërkuar.
- Formulari i regjistrimeve te auditeve te zhvilluara nën monitorimin e kryeauditoreve te certifikuar nga TCP të akredituar.

8.2 PROVIMI

Qellimi i provimit është validimi i aftesive dhe kompetences se kandidatit ashtu sic percaktohet ne kete skeme. Provimi ka si qëllim njohjen e kompetences së kandidatit, praktikisht:

- të thellojë informacionin e paraqitur nga kandidati, të verifikohet eksperienca e viteve të punës, të verifikohet dokumentacioni i paraqitur dhe përputhshmëria e tij me fushën e aplikimit;
- konstatimi i zotërimit të kandidatit për aftësitë e treguara sipas dokumentacionit të kërkuar dhe të paraqitur nga kandidati
- vleresimi i kompetences së kandidatit për të kryer auditime në përputhje me ISO 19011 dhe CEI EN ISO / IEC 17021 (pjesa e aplikueshme)
- konstatimi i kompetences teknike të kodeve (IAF).

Ekzaminuesit janë përgjegjës për vlerësimin e testeve të provimit të kandidatit dhe, për këtë arsye, ata i raportojnë AUTENTICERT-it dhe organeve të detyrueshme (aty ku është e aplikueshme) për të gjithë aktivitetet e vlerësimit.

8.3 MËNYRA E KRYERJES SË PROVIMIT

Seancat e provimit planifikohen dhe menaxhohen nga AUTENTICERT. Kandidati, për të hyrë në provim, duhet të paguajë tarifën e parashikuar në formularin e regjistrimit/aplikimit dhe të sigurojë një dokument identiteti të vlefshëm.

Lista e kandidatëve për provim dhe lista e dokumentacionit të paraqitur prej tyre kontrollohet nga ekzaminuesit. Provimi i kandidatëve zhvillohet në vendodhjen, në datën dhe sipas axhendës të komunikuar nga AUTENTICERT (ose sipas procedurës). Para fillimit të provimit, kandidatët janë të detyruar të:

- paraqesin një dokument identiteti të vlefshëm,
- nënshkruajnë listë pjesëmarrjen,
- nënshkruajnë formularin ku pranojnë "Kushteve e përgjithshme " dhe "Politikën e privatësisë" .
- paraqesin faturën e pagesës së tarifës së kërkuar për pjesëmarrjen në provim.

8.4 TEMAT E PROVIMIT DHE KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas njërës prej metodave të treguara më poshtë . Vlerësimi i procesit në

tërësi kanë për qëllim verifikimin e kompetences për zbatimin e standardeve ISO 45001, ISO 19011, iso 17024 / CEI / EN ISO / IEC 17021 dhe CEI ISO / IEC TS 17021-10, etj

8.4.1 Kriteret për certifikimin dhe ricertifikimin fillestar

Kandidati duhet të demonstrojë:

Për certifikim: zotërimi i parakushteve të kërkuara (kualifikimi arsimor, trajnimi, puna dhe përvoja në terren).

Për ricertifikim: verifikimi i përditësimit profesional (minimumi 24 orë në tre vitet e fundit shih pikën 11 dhe vazhdimësia e veprimtarisë profesionale.

Vazhdimësia e aktivitetit profesional nënkupton nevojën për të demonstruar se kandidati vazhdon të ushtrojë aktivitetin e tij specifik në fushën e verifikimit ose vlerësimit të konformitetit të sistemeve të menaxhimit sipas ISO 45001 në baza të rregullta dhe të qëndrueshme. Kandidati duhet të dokumentojë dhe demonstrojë këtë vazhdimësi përmes regjistrave të auditimit, raporteve të auditimit, kontratave ose letrave të emërimit, detyrave të marra për auditimet e kryera dhe certifikatave të edukimit të vazhdueshëm. Kjo kërkesë siguron që auditori të mbajë aftësi të përditësuara dhe përvojë praktike të konsoliduar, duke siguruar besueshmërinë e vlerësimeve të kryera.

8.4.2 Metodat e vlerësimit për certifikimin dhe ricertifikimin fillestar

Kalimi i provimit i cili do të strukturohet si më poshtë:

TESTI I 30 PYETJEVE ME ZGJEDHJE TË SHUMËFISHTA, I PËRBËRË NGA 4 PËRGJIGJE ME 1 TË SAKTË PËR T'U KRYER NË 60 MINUTA

Temat e mbuluara nga testi me shkrim do të kenë të bëjnë:

- Standardi ISO 45001:2018 – Kërkesat dhe Parimet e Përgjithshme
- Parimet dhe konteksti i standardit
- Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
- Rolet, përgjegjësitë dhe udhëheqja
- Auditimi dhe vlerësimi i konformitetit
- Përmirësim i vazhdueshëm
- Aspektet ligjore dhe rregullatore
- Dokumentacioni dhe të dhënat

STUDIMI I RASTIT QË DO TË ZGJASË MAKSIMUMI 45 MINUTA.

- Planifikimi dhe përgatitja e një auditimi të sistemit të menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë;
- Kryerja e një auditimi dhe menaxhimi i provave objektive;

- Identifikimi, klasifikimi dhe menaxhimi i mospërputhjeve;
- Analiza e shkaqeve dhe përcaktimi i veprimeve korrigjuese;
- Vlerësimi i efektivitetit të proceseve dhe treguesve të performancës (KPI);
- Analiza e kontekstit të organizatës dhe rreziqet që lidhen me proceset;
- Menaxhimi i komunikimit dhe marrëdhënieve me të audituarin;
- Përgatitja e raportit të auditimit dhe menaxhimi i ndjekjes.

PROVIMI ME GOJË PREJ 4 PYETJESH QË DO TË ZGJASË MINIMUMI 20 MINUTA DHE MAKSIMUMI 30.

Pyetjet me gojë mbulojnë fushat e mëposhtme:

1. Kërkesat e standardit UNI EN ISO 45001:2018 dhe zbatimi i tyre praktik në sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë;
2. Identifikimi i rreziqeve, vlerësimi i rreziqeve dhe mundësive dhe planifikimi i veprimeve të përmirësimit;
3. Menaxhimi operacional dhe kontrolli i performancës së shëndetit dhe sigurisë, duke përfshirë monitorimin, aksidentet, lëndimet dhe mospërputhjen;
4. Kryerja e auditimit OHSMS, teknikat e komunikimit me të audituarin, sjellja profesionale dhe hartimi i raportit të auditimit.

Kandidati duhet të kalojë testin, studimin e rastit dhe intervistën teknike me një rezultat prej të paktën 70/100;

Pas pagesës së tarifave të kërkuara, ju do të keni mundësi të hyni në regjistrat përkatës të personelit Autenticert.

Kohëzgjatja trevjeçare e certifikimit duke filluar nga data e lëshimit të certifikatës.

8.4.3 Metoda e vlersimit per kerkesat e vecanta

Kërkesa të veçanta - ref. 6.3.1-6.3.2

Për kandidatët që plotësojnë kërkesat e pikave 6.3.1-6.3.2, provimi me gojë synon:

- që kandidati të mbroje dhe të paraqisi kompetencen e tij profesionale.
- të vlerësohet përshtatshmëria, shkalla e përditësimit të njohurive specifike,
- të verifikohet si kandidati i menaxhon situatat kritike .

Kohezjatja : 60 minuta – Pikët max 20 pikët (min 14)

Kërkesa të vecanta - ref. 6.3.3

Për kandidatët që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 6.3.3, provimi konsiston si më poshte:

Provimi me shkrim :

1) "rast/casus" i referuar i një auditimi i OHSMS

Kohëzgjatja: 60 minuta - Rezultati: max 15 pikë .

2) 20 Pyetje të përgjithshme me alternativa, ku ka vetëm një përgjigje të saktë. Kohëzgjatja: 45 minuta - Rezultati: max 30 pikë.

Minimumi i pikëve për të hyrë në provimin me gojë: 30.5 / 45

Provimi me gojë ka për qëllim:

- Të verifikohen njohuritë bazë.
- vleresohet informacioni i paraqitur nga kandidati per përvojen e punës,
- të vlerësohet sa është i azhonuar me versionet e fundit të standardeve teknike, kodeve IAF
- të verifikojë mënyrën e menaxhimit të situatave,
- të vlerësohet menaxhimi i situatave/ procesit sipas kërkesave të standardartit (ISO 19011 dhe CEI EN ISO / IEC 17021 iso 45001 sipas fushave për pjesën e zbatueshme) sipas rolit si auditues dhe si kryeauditues.
- Të vlerësohet shkalla e njohurive të kodeve IAF,
- vlerësohet kërkesa për certifikim e kandidatit (sipas rolit të kërkuar) me Skemën e Çertifikimit AUTENTICERT.

Kohëzgjatja: 30 minuta - Rezultati: maksimumi 20 pikë (min 12)

Komisioni i Provimit vlerëson përshtatshmërinë e kandidatit sipas kërkesave dhe kritereve specifike të përcaktuara.

- Për ata që kryejnë provimin e plotë , nota maksimale është 100 pikë dhe del nga shuma të notave të marra nga kandidati në provimet e ndryshme. Kufiri **minimal** për të marrë provimin është 70% e shumatores se pikeve e mundshme ne provat e dhena prej kandidatit, max (70 pikë), duke marë parasysh që duhet të marri detyrimish mbi 55 pikë në provimin me shkrim. Prandaj, nëse kandidati nuk e kalon kufirin minimal prej 55 pikësh në testet me shkrim, ai nuk do të pranohet në testin me gojë. Dhe do të duhet përsërisi provimet (atë me shkrim dhe atë me gojë.)
- Për kandidatët që i nënshtrohen provimit të reduktuar : (kandidatët që plotësojnë kushtet e par. 8.4.2), kufiri min i pikëve është 70% Provimi me gojë (14 pikë). Për kandidatët e par. 8.4.3, mund të pranohet ne provimin me goje vetëm nëse marrin mbi 70% të pikëve, në provimin me shkrim te parashikuar.

Komisioni i Provimit, në rastet kur e shikon të arsyeshme, mund të kërkojë edhe një provim shtese i cili mund të zhvillohet si një intervistë ose me shkrim, ose e integruar në mënyrë të tillë që të kuptoj me qartë situatën për dhënien / mirëmbajtjen e certifikimit.

Në fund të provimit, Komisioni i komunikon kandidatit rezultatin e provimit dhe nevojat për përmirësim përgjatë vlefshmërsë së certifikimit.

8.4 RREGULLAT E PËRGJITHSHME

Gjatë provimit me shkrim, kandidatit i lejohet të shikojë dokumente ligjore/ standarte mbi të cilat nuk janë berë shënime me autorizimin e ekzaminuesit, por nuk mund të përdorin celularë apo të shkëmbejnë informacione me kandidatët e tjerë. Mosrespektimi i regullave është arsye për të ndërprere provimin.

8.5 EKZAMINUESIT

Ekzaminimi/vlerësimi kryhet nga ekzaminues të AUTENTICERT-it kompetent që përmbushin të paktën kërkesat minimale të përshkruara në dokumentin "Kerkesat per burimet", të AUTENTICERT.

Ata janë të detyruar të:

- për ruajnë konfidencialitetin e provimit.
- Te kryejne vleresimin e provimit me objektivitet.
- Të deklarojnë çdo lidhje apo marrëdhënie interesi që mund të rrezikojnë paanshmërinë e gjykimit të tyre .
- Të respektoj këtë skemë.

Komisioni i Provimit përbëhet nga një ose më shumë ekzaminues në mënyrë që të mbulohet e gjithe kompetenca e kërkuar për kryerjen e procesit.
Nëse ekzaminimi kryhet nga një personel i jashtëm, Komisioni i Provimit mund të mbikqyret, edhe pa paralajmërim, nga personel i autorizuar nga AUTENTICERT.

8.6 PREZENCA E VËZHGUESIT

Në seancat e provimit, AUTENTICERT mund të kërkojë praninë e vëzhguesve të vet, të DPA-së ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

8.7 PËRSËRITJE E PROVIMIT

Nëse nuk tejkalohet pragu minimal, me 70% të shumës së rezultatit max të arritshëm në testet e kryera nga kandidati, provimi mund të përsëritet. Çdo përsëritje tarifohet.

9 LESHIMI I CERTIFIKATES .

Kandidatit i cili ka kaluar me sukses provimin dhe ka përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara në përputhje me aspektet administrative, AUTENTICERT lëshon certifikatën, që demostron kompetencen e personit dhe plotëson regjistrin përkatës.

Certifikata duhet të ketë:

- Emrin e organizmit që e ka certifikuar (AUTENTICERT
- Emri, mbiemri, nr.personal, datën dhe vend ku ka lindur të personit të certifikuar
- numri të certifikatës
- skema për të cilën është certifikuar dhe/ose referenca mbi standartët/procedura etj.
- data e fillimit të vlefshmërisë
- data e përfundimit të vlefshmërisë
- nënshkrim i personit të autorizuar

9.1 REGJISTRIMI NE REGJISTRAT DHE SHPALLJA

Regjistrimi në regjistrat AUTENTICERT vjen pas dhënies së certifikatës; dhe regjistrimi mund të jetë i aksesueshëm në faqen e AUTENTICERT-it .

9.2 PLOTESIMI I REGJISTRIT

Personi i certifikuar nga AUTENTICERT, si Auditues, mund të kërkojë të certifikohet edhe për kryeauditor ose/ dhe për kode të tjera IAF pasi të ketë marrë certifikatën.

Kjo kërkesë parashikon integrimin e dokumentacionit të plotësuar për certifikimin e mëparshëm duke plotësuar kërkesat e nivelit në vijim dhe kryerjen e pagesave të përcaktuara.

Vlerësimi për pranimin e kandidatit ndodh nëpërmet fazave, të cilat janë të detyrueshme dhe zgjasin në kohë, të përshkrura në paragraf 7 (Procesi i vlerësim) me përjashtim të provimit të certifikimit.

Në përfundim të fazave, AUTENTICERT do të sigurojë përditësimin e regjistrave me informacionet e reja. Certifikata e re jepet pas dorëzimit të certifikatës së vjetër por data e certifikimit nuk ndryshon.

9.3 INTEGRITETI DHE PRIVATIA E TË DHËNAVE

AUTENTICERT, si pronar, garanton që përpunimi i të dhënave të kandidatëve për certifikim të bëhet në përputhje me Rregullore BE 2016/679 dhe të LIGJ Nr.9887, datë 10.3.2008 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE (Ndryshuar me Ligjin, Nr. 48/2012, F.Z. 53) (Ndryshuar me Ligjin,Nr.120/2014, F.Z 160) dhe dokumentet të tjera në lidhje me aktivitetit të certifikimit. Privatësia ruhet për të gjithe personat që marrin pjesë në aplikim. Informacioni i marrë nga stafi që punon në emër të AUTENTICERT, duke përfshirë edhe vendimmarrësit, janë subjekt i ruajtjes së konfidencialiteti.

10. MIRËMBAJTJA E ÇERTIFIKIMIT (MBIKQYRJA)

Vlefshmëria e certifikimit gjatë periudhës kontraktuale prej 5 vjetësh (duke filluar nga data e lëshimit të certifikatës) varet nga rezultati pozitiv i aktiviteteve pas mbikëqyrjes vjetore (perjudha / data është e përcaktuar), të kryer nga AUTENTICERT.

Për këtë qëllim, personi i certifikuar duhet të sigurojë çdo vit një vetëdeklarim, të bërë në zbatim të ligjit/regulloreve/procedurave (me formularë të veçantë të përgatitur nga AUTENTICERT), si më poshtë:

- Pranimin e politikave dhe procedurave e dokumentacionit te AUTENTICERT
- një vertetim, që është ende në punë në fushën për të cilën është certifikuar.
- një vërtetim që nuk ka verejtje në punë dhe ka një vlerësim që konsiderohet pozitiv, për fushën që është certifikuar.

Mirembajtja e certifikatës i nënshtrohet edhe pagesës së tarifave vjetore të parashikuara.

11 RICERTIFIKIM

Ricertifikimi kryet me kerkesë të personit i cili rinovon kontratën dhe vijon me procesin. Rinovimi behet para afatit të skadimit të certifikimit.

Ricetifikimi parashikon përvec dokumentacionit që dorëzohet për mirëmbajtjen vjetore, edhe:

- Jeteshkrimi i përditësuar, me datë dhe i nënshkruar nga vetë kandidati. Të gjitha

dukunte të tjera shtesë të veprimtarive (trajnime...) që ka kryer pas aplikimit të parë si dhe listën e auditimeve që ka kryer përgjatë kesaj perjudhe.

- përvojë nga auditimit specifike në sektor të menaxhimit të cilësisë:
  - për Auditoret: 2 auditime të plota ose 3 auditime mbikëqyrjeje (në të paktën 2 sisteme të ndryshme).
  - si kryeauditor: 3 auditime të plotë ose 5 auditime mbikëqyrjeje (në të paktën 3 sisteme të ndryshme).
  - përditësimi në fushën profesionale për të paktën 24 orë në 3 vjet;

12. KRITERET PËR PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E CERTIFIKIMIT

Shkaqet e pezullimit:
- Përdorimi i gabuar i markës së certifikimit.
- Shkelja e Kodit të Sjelljes
- Mospagesa e detyrimeve
- Mosrespektimi i kërkesave të mirëmbajtjes/rinovimit

Modaliteti i pezullimit:
- Njoftimi me arsyet, kushtet e revokimit dhe kohën.
- Kohëzgjatja maksimale e pezullimit: 6 muaj
- Në mungesë të veprimeve korrigjuese: revokimi

Efektet e pezullimit:
- Përdorimi i certifikatës dhe markës tregtare është i ndaluar
- Detyrimi për të informuar klientët nëse certifikata është vendimtare
- Në rast shkeljeje: revokim i menjëhershëm

Revokimi i certifikatës :
- Komunikohet në Organin e Akreditimit (për regjistrat e akredituar) dhe publikohet në faqen e internetit të Autenticert
- Asnjë rimbursim i pagesave të bëra ose të detyrueshme
- Mundësia e një aplikimi të ri për certifikim pas 3 muajsh (zgjidhja e padive)

Pezullimi i certifikatës sipas kërkesës:
- E mundur deri në 1 vit në rast të ndërprerjes vullnetare të aktivitetit
- Rifillimi i aktivitetit: komunikimi dhe provimi i ri

Përjashtime:
- E mundur me një kërkesë të arsyetuar (p.sh. maternitet) për periodicitetin e mirëmbajtjes, pasi të ketë vlerësuar arsyet e një kërkese të tillë

Rezultati i vlerësimit komunikohet me shkrim nga Autenticert